




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



DREJTORIA E NDIHMËS  
JURIDIKE FALAS



UNIVERSITETI EUROPIAN  
I TIRANËS

Nr. 174 Prot.

Tiranë, më 4/6/2020

Nr. 101 Prot.

Tiranë, më 04/06/2020

### MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

### PËR DHËNIEN E NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE

Sot më datë, 04.06.2020, lidhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Palëve:

Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, me adresë: Bulevardi "Zog I", pranë Ministrisë së Drejtësisë, përfaqësuar nga Znj. Ani Grizhja

dhe

Shoqëria European Education Initiative sh.p.k, person juridik i së drejtës shqiptare, me emër tregtar "Universiteti European i Tiranës" regjistruar në QKR me NIPT K62029010L, me seli në adresen: Bulevardi "Gjergj Fishta" Tiranë, përfaqësuar nga Rektori, Prof. Dr. Nevila Nika, (këtu e më poshtë referuar si UET);

Palët në këtë marrëveshje bien dakord si më poshtë:

## **Baza ligjore**

Kjo marrëveshje bazohet në Kodin Civil, Pjesën V, Titulli I, Ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” nenit 8, pika “e”, nenit 16, Ligji nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, në Republikën e Shqipërisë”, dhe aktet nënligjore të nxjerrë në zbatim të tij, dhe Statutit të Universitetit European i Tiranës, miratuar me Urdhrin nr. 90 datë, 28.02.2017, të Ministrit të Arsimit dhe të Sportit

Neni 1

## **Qëllimi**

Me angazhimin për të asistuar njëri-tjetrin mbi parimin e reciprocitetit dhe me bindjen se bashkëveprimi i palëve sipas kësaj Marrëveshje është në ndihmën dhe interesin e studentëve dhe personave ne pamundësi ekonomike për te përballuar përfaqësimin ligjor nga avokati, atëherë palët synojnë të rregullojnë me këtë Marrëveshje, bashkëpunimin e tyre të vazhdueshëm, duke përcaktuar parimet e përgjithshme që do të qeverisin (udhëheqin) marrëdhëni e tyre.

Neni 2

## **Objekti**

Objekti i kësaj Marrëveshje është ofrimi i ndihmës juridike parësore sipas përcaktimeve në këtë marrëveshje.

Neni 3

## **Përkufizime**

Në këtë Marrëveshje termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Ndihma juridike parësore” ka të njëtin kuptim sipas nenit 3 të pikës ”b” të Ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.
2. “Palët “janë Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas dhe Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, pranë të cilët është ngritur klinika ligjore.
3. “Regjistri i kërkesave dhe vetë deklarimeve” është formati i regjistrat i miratuar nga Ministri i Drejtësisë me Urdhër Nr. 225, datë 25.03.2019.
4. “Sistemi unik i të dhënave” është sistemi elektronik online për ngarkimin e të dhënave, i aksesueshëm nga ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore.



## Neni 4

### Të drejtat dhe Detyrimet e Institucioni të arsimit të lartë Universitetit European i Tiranës

1. Institucioni i arsimit të lartë, Universitetit European i Tiranës është aktiv në hapësirën e arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor si në Shqipëri, ashtu dhe në arenën ndërkombëtare, në nisma novatore dhe zhvilluese, në botime akademike dhe shkencore, në projekte ndërinstitucionale si dhe në tregun e punës ku ofron një garanci për studentët, duke i paraprirë ndryshimeve që shfaq ekonomia e tregut.
2. Institucioni i arsimit të lartë Universitetit European i Tiranës pranë të cilit është ngritur klinika ligjore do të ofrojë ndihmën juridike parësore sipas procedurave ligjore për dhënen e ndihmës juridike parësore të parashikuara në nenin 17 të Ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.
3. Klinika ligjore do të mbajë, plotësojë dhe përditësojë regjistrin e vetë deklarimeve të personave që kanë aplikuar të përfitojnë ndihmën juridike parësore. Regjistri do të mbahet në mënyrë elektronike. Ngarkimi i të dhënavëve do të bëhet edhe në sistemin Unik të të dhënavëve.
4. Klinika ligjore do dërgojë të dhëna periodike çdo muaj Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas mbi personat të cilët kanë aplikuar / përfituar ndihmën juridike. Të dhënat do të dërgohen brenda 5 (pesë) ditëve të para të muajit pasardhës të muajit referues.
5. Përzgjedhja e studentëve që do të përfshihen në ofrimin e ndihmës juridike parësore pranë klinikës ligjore do të bëhet sipas përcaktiveve të parashikuara në statutin e IAL-së Universitetit European i Tiranës dhe irregullores se Klinikës së Ligjit. Në çdo rast numri i studentëve nuk mund të jetë më shumë se 10 studentë.
6. Klinika ligjore mund të japë opinione, sugjerime, të kërkojë informacione apo ndihmë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas për çështje / probleme që lidhen me ofrimin apo përmirësimin e ndihmës juridike parësore.
7. Klinika ligjore ndërmerr fushata për irritjen e ndërgjegjësimit dhe edukimit ligjor të publikut veçanërisht informimin e studentëve të universitetit / fakultetit mbi kriteret dhe kushtet e përfitimit të ndihmës juridike parësore.
8. Klinika ligjore ka të drejtë të përfitojë financime nga donatorë të ndryshëm të cilët ofrojnë mbështetje në fushën e Ndihmës Juridike.
9. Klinika e ligjit ofrojnë zyra të brendshme të përshtatshme për pritjen e klientëve, të aksesueshme edhe nga persona me aftësi të kufizuar. Klinika mban arkivin elektronik dhe është e pajisur me mjetet minimale të punës. Për aq sa është e mundur Klinika, ofron shërbimin e ndihmës juridike parësore sipas standardeve të përcaktuara në Urdhrin Nr. 531 Prot., datë 25.11.2019 të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e kritereve dhe metodologjinë për vlerësimin e cilesise se ofrimit të

shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të Shërbimeve të Ndihmës Juridike".

#### Neni 5

#### **Të drejtat dhe Detyrimet e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas**

1. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas (DNJF) do të ofrojë kushte për trajnimin dhe përditësimin e njojurive të studentëve të përfshirë pranë klinikës ligjore, mbi çështjet e lidhura me ndihmën juridike parësore.
2. Për aq sa është e mundur do të sigurojë informacione, këshillime apo ndihmën e kërkuar nga klinika ligjore për zgjidhjen e problemeve me të cilat do të përballet kjo e fundit gjatë ofrimit të ndihmës juridike parësore.
3. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka të drejtë të kërkojë nga klinika ligjore informacione apo të dhëna periodike.
4. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas mbështet klinikën ligjore dhe me kërkesë të kësaj të fundit merr pjesë në fushata për ndërgjegjësimin dhe edukimin ligor të publikut.

#### Neni 6

#### **Komunikimi mes palëve**

1. Palët bien dakord të shkëmbejnë informacione, të dërgojnë apo marrin të dhëna të ndryshme përmes postës elektronike apo çdo formë tjetër të parashikuar në ligj.
2. Për këtë qëllim palët do të caktojnë personat e kontaktit me të dhënat si më poshtë:
  - Për Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas: Personi i kontaktit Z. Ilberjan Durmishi nr. Cel. 0675500812; e-mail: [ilberjan.durmishi@drejtesia.gov.al](mailto:ilberjan.durmishi@drejtesia.gov.al); [dnjf@drejtesia.gov.al](mailto:dnjf@drejtesia.gov.al).
  - Për klinikën ligjore: Personi i kontaktit, Av. Ilir Korbi, nr. Cel. 0695297133, e-mail: [ilir.korbi@uet.edu.al](mailto:ilir.korbi@uet.edu.al); [ilkorbi@yahoo.it](mailto:ilkorbi@yahoo.it).
3. Në çdo rast palët njofojnë për ndryshimin e të dhënave dhe personit të kontaktit.

#### Neni 7

#### **Mbrojtja e të dhënave personale dhe konfidencialiteti**

1. Palët marrin përsipër të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave apo të informacioneve me të cilat janë vënë në dijeni gjatë dhënies së ndihmës juridike parësore.

2. Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave personale të kerkuesve të ndihmës juridike parësore do të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Palët, do të ndërmarrin të gjitha hapat dhe masat për ruajtjen e informacionit të shkëmbyer mes tyre, përpara, gjatë dhe pas përfundimit të ekzekutimit të kësaj Marrëveshje.

3. Çdo e drejtë e pronësisë intelektuale e mbajtur nga një Palë do të mbetet në pronësinë e saj të plotë dhe përdorimi i saj që mund t'u lejohet Palës tjetër në kontekstin e kësaj Marrëveshje por nuk do të nënkuptojë njojhen e ndonjë licence apo të drejtë.

Neni 8

### **Ndryshimi dhe zgjidhja e Marrëveshjes**

1. Palët janë të lira të propozojnë ndryshimet e kushteve të kësaj Marrëveshjeje.
2. Me njoftimin me shkrim, çdo palë në çdo kohë mund të kërkojë zgjidhjen e kësaj Marrëveshje pasi të këtë njoftuar paraprakisht palën tjetër.

Neni 9

### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Palët bien dakord që bashkëpunimi i tyre do të respektoje dhe nuk do të cënojë aktet ligjore dhe nënligjore, mbi të cilën funksionojnë palët si dhe praktikat e mira, traditë e tyre.
2. Mosmarrëveshjet që lindin mes palëve do të zgjidhen me mirëkuptim mes tyre. Nëse kjo nuk është e mundur palët mund t'i drejtohen gjykatës kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Neni 10

### **Angazhimet financiare**

1. Për zbatimin e kësaj Marrëveshjë asnjë nga palët nuk është e detyruar të marrë përsipër detyrimë financiare fillestare, në vazhdimësi apo të parashikojë fond të veçantë në buxhetin e saj.
2. Pavarësisht parashikimeve në paragrafin e parë të këtij nenii, palët nuk lirohen nga të drejtat dhe detyrimet që kanë marrë përsipër në këtë Marrëveshje.

Neni 11

### **Hyrja në fuqi**

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga të dyja palët.

Neni 11

### Të ndryshme

Kjo Marrëveshje hartohet në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë ligjore ku secila palë merr një prej tyre.

2. Çështjet të cilat nuk janë parashikuar shprehimisht në këtë Marrëveshje do të rregullohen sipas Pjesës V, Titulli I, të dispozitave të Kodit Civil të miratuar me ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994, i ndryshuar.

3. Palët do të nxisin njëra tjetrën për një bashkëpunim sa më të gjerë dhe intensiv duke eksploruar fusha të reja bashkëpunimi dhe duke forcuar ato aktuale. Iniciativa "të tjera" do të zhvillohen në konsultim midis palëve dhe do të negociohen dhe do të nënshkruhen me Marrëveshje përkatëse me shkrim nga dyja palët.

*Ky akt përbën marrëveshjen e plotë ndërmjet palëve, të cilat, pasi e lexojnë dhe pasi gjejnë të shprehur në të, vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, e nënshkruajnë atë rregullisht për të gjitha efektet e ligjit.*

PËR

DREJTORINË E NDIHMËS

JURIDIKE FALAS

përfaqësuar nga

(në mungesë)

DREJTORI I DREJTORISË

SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS



PËR

UNIVERSITETIN EUROPIAN TË

TIRANËS

përfaqësuar nga

REKTORI  
PROF.DR. NEVILA NIKA

